



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.09.2018, ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 10849, datë 27.07.2018, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: “Projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”” (*komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Florjon Mima, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Lorenc Luka, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Edmond Leka, Vullnet Sinaj, Endrit Brahimllari, Edmond Panariti dhe Viktor Tushaj.

Mungojnë:

Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Bledar Dervishaj - Këshilltar ligjor i Presidentit të Republikës,

Krisilda Fana - Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Sigurisë.

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Siç jeni njoftuar, në vijim të axhendës së ditës së sotme, kemi parashikuar shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10 849, datë 27.07.2018, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 37/2018 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar".

Me të marrë dekretin e Presidentit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U sistemuat?

Mund ta kishim bërë mbledhjen në një mjedis tjetër më të madh, nëse do ta dinim që do të kishte një pjesëmarrje kaq të zgjeruar.

Gjithsesi, pasi morëm dekretin e Presidentit, edhe për shkak të debatit publik për të cilin të gjithë jemi në dijeni, unë, si kryetar i komisionit, mbasi jam konsultuar me komisionin, vendosa të presim pak për shkak se një grup deputetësh të opozitës ka pasur një korrespondencë me Delegacionin e BE-së.

Gjithashtu, jemi në dijeni edhe të korrespondencës që ka pasur midis Delegacionit të BE-së dhe sekretarit të Përgjithshëm të KM-së.

Ndërkohë, gjykojmë që në një moment ta përfshijmë në diskutim për shkak se njëra nga pikat e dekretit të Presidentit dhe njëra nga çështjet e debatueshme ka pasur të bëjë me konkurrencën. Duke pasur parasysh të gjitha këto diskutime, të gjithë këta aktorë të përfshirë, kërkojmë të presin përfundimin e dhënies së opinioneve. Mbas një shqyrtimi të kujdesshëm dhe të matur të gjithçkaje që ishte shkruar së paku, sepse për atë që është dëgjuar ishim koshientë, të marrim në konsideratë, pa kurrfarë paragjykimi, të gjitha argumentet e parashtruara.

Kemi arritur në konkluzionin e pranimi të dekretit të Presidentit.

Nuk është rasti i parë që Kuvendi pranon dekretin e Presidentit, por kemi raste kur është kërkuar të rrëzohet, si dhe raste kur, mbi bazën e gjykimit të argumenteve, është kërkuar të reflektohet dhe të ndërhyhet në nene të veçanta.

Siç e thashë, pas shqyrtimit të kujdesshëm të gjithçkaje sa është shkruar në lidhje me këtë ligj, kemi ndërmarrë edhe disa diskutime me individë të ndryshëm apo disa sugjerime, që kanë ardhur në vëmendjen e komisionit, si, për shembull, lidhur me afatet që do të kihen në konsideratë pas ndryshimit të propozuar për një thirrje të hapur.

Ndër diskutimet që kemi bërë me grupe të ndryshme, kemi arritur sot në një draftpropozim që do ta shqyrtojmë në komision në lidhje me amendimet që do të bëjmë për këtë ligj. Pra, do të pranojmë, dhe ky është sugjerimi im, si kryetar i komisionit për ju, dekretin e Presidentit, duke ndërhyrë në disa nene të veçanta.

Nga leximi i kujdesshëm i dekretit, por edhe i argumenteve të tjera që kanë shtruar institucione të ndryshme të përfshira në debat, nuk ka sugjerime të veçanta konkrete për nene të veçanta. Ndaj ne kemi një draft, të cilin ju e keni përpara, por unë do të doja fillimisht t'ia jepja fjalën relatorit, zotit Beqaj, për të bërë një shpjegim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, të lutem, sepse fjalën e ka zoti Beqaj për të bërë një shpjegim!

Pasi relatori të shpjegojë propozimet e ndryshimeve që ne kemi paraqitur, do t'ia jap fjalën përfaqësuesit të opozitës, nuk e di, do të jetë nënkryetari i komisionit apo kush do të jetë, për të kaluar më tej në procedurën e votimit.

Jemi drejtpërdrejt në transmetim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, për procedurë, përpara se t'ia jap fjalën relatorit të çështjes, fjalën e ka zonja Vokshi.

Vetëm diçka: do t'u lutesha të gjithë atyre që janë për herë të parë në këtë komision, sepse kemi pasur edhe këtu në të kaluarën disa eksperiencë, do të thosha, shumë të shëmtuara të të folurit pa rregull, të marrjes së fjalës pa kurrfarë norme, të të folurit pa kurrfarë standardi, ama kemi disa vite që e kemi respektuar njëri-tjetrin, edhe kur nuk kemi rënë dakord për argumente të ndryshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndaj, meqenëse sot shoh një pjesëmarrje të zgjeruar të opozitës, për ato që ndoshta nuk e dinë, jam i detyruar të them se kush do ta marrë fjalën, tani e ka zonja Vokshi për procedurë, prandaj edhe bëra parashtrimin e shqyrtimit se si do të procedojmë, por do t'ju lutesha që atë

standard, së paku në këtë komision, ku do të dëgjojmë njëri-tjetrin, pa u bërë të papëlqyeshëm për njëri-tjetrin, duhet ta respektojmë. Në të kundërt, do të jem i detyruar që për çdo rast kur do të shoh shmangie, siç kam vënë re në komisione të tjera, të procedoj duke respektuar...

Albana Vokshi – Sa në siklet qenke; qenke në shumë siklet! Çfarë do të themi?

Eduard Shalsi – Zonja Vokshi...

Albana Vokshi – Na e jepni fjalën.

Eduard Shalsi – ... ju lutem!

Albana Vokshi – Pse jeni në siklet?

Eduard Shalsi – Ja po ta them!

Albana Vokshi – Nuk ka asgjë për t'u sikletosur.

Eduard Shalsi - Në komisionin që drejton ti bëj çfarë të duash, kurse këtu, të paktën për sa kohë do ta drejtoj unë, duhet të respektosh kolegët duke ngritur dorën për të marrë fjalën. Të lutem shumë, nëse do që të qëndrosh në këtë komision, duhet të respektosh rregullat e parlamentit, jo normat dhe rregullat e mia. Është e vërtetë që jam në siklet sa herë shkelet etika, fyhen kolegët dhe tejkalohen normat minimale të edukatës.

Fjala për ju për procedurë.

Albana Vokshi – Sigurisht që për procedurë.

Qenkeni në siklet për etikën, por nuk jeni në siklet për vjedhjen dhe për krimin që po bëhet me anë të ligjit, që ju e miratuat me 74 vota. Nuk është aspak e çuditshme që sa herë ka një projekt të tillë, korruptiv dhe kriminal, del emri i relatorit, Ilir Beqja, i cili do të relatojë edhe për pjesën korruptive dhe kriminale të arnimit që do t'i bëhet ligjit Rama-Fusha apo një ligji tjetër. Ne nuk kemi asnjë draft përpara dhe nuk e kuptoj pse e mbani të fshehur. Të paktën atë që keni qëllim të bëni, silleni. Dekreti votohet pro ose kundër. Unë nuk e kuptoj pse keni sjellë sot amendime të një dekreti, i cili është shumë i qartë. Ligji Rama-Fusha është antikushtetues dhe kriminal, sepse kërkon të bëjë pastrimin e parave duke ndërtuar gjashtë kulla për një përfitim të pastër prej 205 milionë eurosh.

Eduard Shalsi – Një sekondë. Po flasim për procedurë.

Albana Vokshi – Po flas për dekretin. Mos kini frikë!

Eduard Shalsi – Një sekondë.

Albana Vokshi – E kam marrë fjalën për procedurë. Të lutem zoti Shalsi, mos më ndërprit!

Eduard Shalsi – Kërkesa për procedurë ...

Albana Vokshi – Të lutem, zoti Shalsi ...

Ndërpritet mbledhja. Rimblidhemi pas dhjetë minutash.

Albana Vokshi – Si e mbyll mbledhjen kur sapo e hape?

(Diskutime pa mikrofon)

Ta mbaroj unë fjalën pastaj ndërprite ti. Ti po shkel Rregulloren, atë që përmende më parë.

(Rifillon mbledhja)

Eduard Shalsi – E mbajta shënim ndërhyrjen për procedurë në lidhje me draftin ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, të lutem! A ka mundësi?

Propagandë le të shkojnë të bëjnë dhe të menaxhojnë komisionet si të duan ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka të drejtë. Mos më përsërisni skena ... Jam shumë i qartë.

Albana Vokshi – Zoti kryetar, më jepni fjalën. Pse keni frikë?

Nuk e kuptoj se me çfarë fytyre dhe kuraje e merr përsipër një projekt të tillë? Si mund të më ndërpresësh fjalën? Nuk mund ta bësh këtë gjë, sepse jam deputete. Mos shkel Rregulloren.

Eduard Shalsi – Nuk ka në këtë komision ...

Albana Vokshi – Më jep fjalën dhe mos ki frikë.

Eduard Shalsi - Po më detyroni të veproj si në mbledhjen e shkuar.

Albana Vokshi – Zoti kryetar, më jep fjalën. Mos shkel Rregulloren.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi - Se çfarë kam të drejtë unë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Vokshi – Të gjithë e lexojmë Rregulloren.

Ka mikrofon këtu, zoti Gurakuqi. Mos bëni sikur vini nga ...

Albana Vokshi – Zoti kryetar, kam kërkuar fjalën për procedurë dhe duhet të më jepni fjalën për procedurë.

Eduard Shalsi – Ju thashë, skenat e shëmtuara që keni lejuar nëpër komisionet e tjera, sidomos ju që jeni titullarë, nuk ka shans të ndodhin në këtë komision.

Albana Vokshi – Edhe ju nuk keni shans të mos më jepni mua fjalën. Nuk keni shans! Nuk e shkelni dot Rregulloren. Më jepni fjalën për procedurë!

Eduard Shalsi – Atëherë kalojmë te propozimi...

Albana Vokshi- Zoti kryetar, mos u bëni palë me krimin, më jepni fjalën!

Eduard Shalsi – Një sekondë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka shanse të bëni karagjozllëqet që bëni nëpër komisionet e tjera.

Albana Vokshi – Më jepni fjalën! Çfarë frike keni ju, zoti kryetar, nga fjala.

Nuk e vazhdoni dot këtë mbledhje pa më dhënë mua fjalën.

Eduard Shalsi – Do të hedhim në votim dekretin të Presidentit. Dakord?

Merruni vesh me njëri-tjetrin. Procedura...

Albana Vokshi – Zoti Shalsi, sot ju po bëheni palë me hajdutët dhe me kriminelët. Ju sot kishit shans të kërkonit falje për këtë paçavure dhe për këtë vjedhje.

Eduard Shalsi – Kush është dakord që të pranohet dekreti i Presidentit?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Pra, pranuar dekretin e Presidentit.

Albana Vokshi – Si e hedh në votim, ka diskutime. Ti po shkel Rregulloren!

Eduard Shalsi – Mua më vjen keq vetëm për një gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qetësohuni, sepse nuk flas dot me 20 veta njëkohësisht.

Albana Vokshi- Mos shkelni Rregulloren dhe më jepni fjalën!

Eduard Shalsi- Edhe një herë, gjykova që ka për procedurë një sugjerim dhe mora...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lër ta mbaroj, nuk je në pyll këtu. Ik fol andej! Kush t'i ka mësuar rregullat?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Vokshi – Nuk e përcaktoni ju, por Rregullorja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Mos i jep përgjigje, sepse atë di të bëj te komisioni i saj, atë do të bëjë edhe këtu. Me atë xhungël janë mësuar atje dhe atë do të bëjnë edhe këtu.

Albana Vokshi –Xhungla e vjedhjes që po bëni ju me kullat. Kjo është xhungla!

Eduard Shalsi – Edhe një herë. Keni draftin përpara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

As nuk e marr në konsideratë fare. Je nënkryetar i komisionit dhe mund të nderësh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të marrësh mikrofonin, je nënkryetar...

Albana Vokshi – Zoti Shalsi, është e turpshme që ju e mbroni këtë ligj sot. Nuk e kuptoj me çfarë kuraje merrni përsipër që të diskutoni?! A keni ndërgjegje apo jo?

Eduard Shalsi – Para se të kalojmë në votim, kam një propozim.

Albana Vokshi- Jeni bërë të gjithë hajdutë dhe kriminelë.

Jorida Tabaku – Zoti Shalsi, kemi kërkuar tre vetë fjalën për procedurë.

Eduard Shalsi – Jemi te pjesa racionale dhe po ju them...

Jorida Tabaku – Kemi kërkuar...

Eduard Shalsi – Nuk është procedurë të bësh propagandë.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Bylykbashi, ti ma kërrove fjalën për procedurë dhe unë kam predispozicionin më të madh për ta dhënë, ndërkohë që zoti nënkryetar i komisionit më thotë që t'ia jap fjalën zonjës Vokshi, ndërkohë që zonja Tabaku kërkon fjalën mua, ai tjetri flet atje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Vokshi – Je shumë konfuz, ti nuk di se çfarë bën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Edhe një herë, kur fjala jepet për procedurë, do të flitet për procedurë. Në rast se keni ndër mend të bëni show-n dhe propagandën si ato që bëni te komisioni tjetër, shkoni dhe bëjini atje.

(Diskutime pa mikrofon)

Ta dëgjoj pak atë se çfarë thotë? Nuk është mirë për asnjërin nga ne kjo lloj sjelljeje. Ju lutem, qetësi!

(Diskutime pa mikrofon)

Albana Vokshi – E kuptojmë që je shumë në siklet. Këtë barrë vetëm ti mund ta merrje përsipër. Vetëm ju, zoti Shalsi, mund ta merrni përsipër; siç morët ato të plehrave, po merrni përsipër edhe aktin më antiligjor dhe më antikushtetues për hir të një karrigeje, dhe ky është një turp i madh, që bëheni palë me kriminelët dhe hajdutët!

Eduard Shalsi – Albana, po ta them shumë sinqerisht, nuk ka siklet më të madh se sa të dëgjosh të flasësh pa rregulla dhe pa norma, është e sikletshme.

Albana Vokshi – Ju, zoti Shalsi, si mundët që kishit shansin sot të tërhiqeshit dhe të kërkonit falje, sot e kishit këtë shans.

Eduard Shalsi – Miratuam në parim dekretin e Presidentit. Dua të bëj një shpjegim...

(Diskutime pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Domethënë, ratë dakord që ligji është antikushtetues, ratë dakord që e tërhoqët ligjin?!

Eduard Shalsi – Si ramë dakord?!

Albana Vokshi – E votuat dekretin e Presidentit.

Jorida Tabaku – Domethënë, ligji është antikushtetues, ligj shkel 5 ligje të tjera, ramë dakord që i gjithë “ligji Fusha” bie. Këtë procedurë duam të sqarojmë.

Eduard Shalsi – Të lutem, fike pak mikrofonin!

Jorida Tabaku – Zoti Shalsi, një sekondë të mbaroj. Dekreti i Presidentit u miratua, ligji ra poshtë. Kjo mbledhje mbyllet këtu. Kaq. Nuk ka më asnjë diskutim.

Eduard Shalsi – Mbaruat?

Jorida Tabaku – Nuk kam mbaruar akoma.

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Qetësohuni, sepse po flas me zonjën Tabaku!

(Diskutime pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Zoti Shalsi, 30 sekonda me qetësi, sepse e kuptoj që je në pozitë të vështirë.

Së pari, këtu në këtë mbledhje të gjithë duhet t’i kërkojmë ndjesë opozitës, qytetarëve që keni miratuar një ligj antikushtetues, që ka kaluar çdo hallkë të shtetit...

Eduard Shalsi – Mbaruat një sekondë për procedurë?

Jorida Tabaku - ...dhe sot vini këtu dhe na vendosni përpara një ligj tjetër.

Eduard Shalsi – Të lutem, mbylleni!

Jorida Tabaku – Një sekondë, nuk kam mbaruar.

Eduard Shalsi – Në qoftë se do të bësh deklaratë, merr mediet, nxirri jashtë dhe bëj çfarë të duash...

Jorida Tabaku – Nuk është deklaratë, jam për procedurë. Zoti Shalsi, jam ende për procedurë.

Eduard Shalsi – I paedukatë jam me të paturpshmit që flasin pa leje, që flasin jashtë procedurës.

Albana Vokshi – Ti sot po bëhesh palë me hajdutët dhe kriminelët. Këtë pranoni.

Eduard Shalsi - Atë e pranoj!

Albana Vokshi – Ti nuk mund të kalosh një ligj që shemb Teatrin Kombëtar. Tërhiquni dhe rrëzoni ligjin, kaq!

Eduard Shalsi – Zoti Bylykbashi, në praktikën e këtij parlamenti, keni rastin e ligjit të legalizimeve të viteve 2006-2008, është miratuar dekreti i Presidentit dhe janë amenduar nene të ligjit. Përsëri keni ligjin “Për masat e sigurisë publike”, ka ardhur dekreti i Presidentit, është miratuar dekreti i Presidentit dhe mbi dekret është reflektuar dhe janë bërë amendamente. Ajo që po propozoj sot, në rast se do të kishit...

Oerd Bylykbashi - Zoti Shalsi, Rregullorja dhe Kushtetuta nuk janë veprimtari prodhuese, nuk bëhen me sipërmarrje, është e shkruar.

Eduard Shalsi - Të lutem, të mbaroj!

Po përpiqem t’ju sqaroj logjikën që po përdorim, sepse zonja Tabaku ngriti një shqetësim.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk është çështje më e ke për herë të parë këtu. Ngaqë je rishtar dhe sefte këtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta them. Nuk është turp ta kesh për herë të parë. Pse acarohesh?

Albana Vokshi – Shals, ti je përsëritës dhe e di i mirë këto, pra antikushtetushmërinë dhe antiligjshmërinë...

Eduard Shalsi – Po ju them se në praktikën parlamentare, që e keni bërë ju kur keni qenë në pushtet (e ka bërë ky parlament pavarësisht se kush ka qenë apo s’ ka qenë në pushtet)

dekretet e Presidentit rrëzohen, miratohen, ose miratohen me ndryshime. Ne jemi këtu te rasti i trete...

Oerd Bylykbashi – Cili miratohet me ndryshime? Është budallallëk kjo që po thoni...

Jorida Tabaku – Si miratohet dekreti më ndryshime?

Eduard Shalsi – Vazhdo, Beqaj!

Albana Vokshi – Nuk ia jep dot fjalën atij ti.

Eduard Shalsi – Beqaj, kalo te nenet.

(Ndërhyjnë njëkohësisht disa deputetë)

Ilir Beqaj – Meqenëse jemi në kushtet që e votuam dekretin dhe meqenëse Rregullorja thotë që...

Albana Vokshi – Që nuk ia jep dot fjalën Ilir Beqjas pa na e dhënë fjalën neve. Nuk e bën dot.

Ilir Beqaj – Raporti i komisionit thotë se, sipas rastit, përmban edhe propozime për nene të veçanta dhe ky është neni 86 i Rregullores. Vetë Presidenti në dekret është shprehur dhe thotë, bazuar në argumentet, të cilat tashmë i dimë, i shterua dhe një pjesë i pranua, se prandaj e votuam pro...

Jorida Tabaku – Jo një pjesë, e pranuat të gjithin. E miratuat në tërësi dekretin...

Ilir Beqaj – Presidenti e fton Kuvendin ta rishqyrtojë në tërësi ligjin. Unë në cilësinë e relatorit...

Albana Vokshi – Është ligj tjetër...

Ilir Beqaj – ...ju propozoj si komision, në qoftë se doni të dëgjoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu që...

Jorida Tabaku – Nuk futemi dot në diskutimin e neneve.

(Flasin njëkohësisht disa deputetë)

Zoti Shalsi, ka rënë i gjithë ligji. Sapo e miratuat që është jokushtetues...

Ilir Beqaj – Në nenin 1, përpara shprehjes “negocim” shtohet edhe shprehja “vlerësim”.

Neni 2 nuk ndryshon.

Përmbajtja e nenit 3 bëhet e re dhe po e lexoj: “Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autorizim i komisionit të vlerësimit dhe negocimit” është tagri që gëzon komisioni i vlerësimit dhe negocimit për të përfaqësuar pronarin-shtet me të drejta të plota, për të vlerësuar dhe tjetërsuar pronat në pronësi të pushtetit qendror apo të vetëqeverisjes vendore për zhvillimin e këtij projekti, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij ligji.

Jorida Tabaku – Nuk hyjmë dot në diskutim, se kanë rënë ligji...

(Flasin disa deputetë njëkohësisht.)

Ilir Beqaj – 2. “Autorizim i kryetarit të bashkisë” është tagri që gëzon kryetari i bashkisë apo personi i autorizuar prej tij për të përfaqësuar pronarin-shtet me të drejta të plota për të nënshkruar kontratën me palën private, për zhvillimin e projektit sipas parashikimeve të këtij ligji.

(Flasin disa deputetë njëkohësisht.)

3. “Kontrata” është kontrata e shkëmbimit, që lidhet ndërmjet palës private dhe Bashkisë së Tiranës, e cila ka për objekt kalimin e ndërsjellë të pronësisë së sendeve ose të të drejtave të tjera nga pronari-shtet te pala private dhe anasjelltas, sipas parashikimeve të Kodit Civil.

4. “Palë private” është çdo subjekt privat që paraqet një propozim për zhvillimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, duke përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar.

5. “Palë private e përzgjedhur” është pala private, propozimi i së cilës ka rezultuar në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe më i favorshmi në raport të interesit publik dhe është klasifikuar i pari nga Komisioni.

Jorida Tabaku – Është e kotë. Zoti Shalsi, nuk mund të fillojmë

Albana Vokshi – Kryetar, do të ma japësh fjalën, apo jo?

Ilir Beqaj – 6. “Projekti” është ndërtimi i godinës së re të Teatrit Kombëtar dhe zhvillimi i zonës ndërmjet rrugëve “Abdi Toptani” dhe “Murat Toptani”, sipas propozimit të paraqitur nga pala private.

(Flasin disa deputetë njëkohësisht.)

7. “Godina e Teatrit” përfshin ndërtimin e objektit, mobilimin e brendshëm, instalimet teknologjike të skenave, instalimet audio/video, si edhe të çdo elementi tjetër të nevojshëm për një teatër bashkëkohor e modern, ndërtimin e objektit, aksesin dhe shërbimet për publikun, duke garantuar sipërfaqen aktuale funksionale përreth ndërtimit të ri.

8. Prona shtetërore është prona e paluajtshme shtet e pushtetit qendror dhe vendor, që vendoset në dispozicion zhvillimit të këtij projekti.

(Flasin disa deputetë njëkohësisht.)

9. “Komisioni i vlerësimit dhe negocimit”, në vijim “Komisioni”, është grupi ndërinstitucional, i krijuar sipas nenit 5, të këtij ligji.

10. “Tjetërsim” është vendosja në dispozicion e pronës shtetërore në shkëmbim të zhvillimit të projektit.

11. “Thirrje e hapur” është ftesa e hartuar nga komisioni për palët private që janë të interesuara për të paraqitur një propozim për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, duke përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj.

Klevis Balliu – Zotëri, është vjedhje. E bëtë një herë, ju thamë se është vjedhje. Sot ulët kokën dhe e pranuat. Tani doni ta bëni me lezet...

Ilir Beqaj – 12. “Miratim i kontratës” është miratimi me ligj nga Kuvendi i kontratës së paraqitur nga Këshilli i Ministrave dhe të nënshkruar nga kryetari i bashkisë apo personi i autorizuar prej tij.”

Neni 4 nuk ndryshon.

Neni 5 nuk ndryshon.

Neni 6 ndryshon nga e para: “Kompetencat e komisionit”

1. “Komisioni shqyrton propozimet e paraqitura nga çdo palë e interesuar për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, duke përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Albana Vokshi – Ilir, boll me vjedhjet!

2. “Sipas nenit 4, të këtij ligji, institucionet përkatëse duhet të vendosin menjëherë në dispozicion të komisionit vlerësimin financiar të pasurive shtetërore, për të cilat ai do të negociojë me palën private, në lidhje me përfitimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar. Anëtarët e komisionit i ushtrojnë kompetencat e tyre sipas fushës së përgjegjësisë së institucioneve që përfaqësojnë.

3. Me marrjen e propozimeve, Komisioni verifikon paraprakisht statusin e të gjitha pronave mbi të cilat do të zhvillohet projekti, sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 3 të këtij ligji. Komisioni verifikon dhe marrëveshjet e arritura dhe të nënshkruara me pronarët privatë që posedojnë pasuritë në zonën e zhvillimit të projektit.
4. Komisioni vlerëson propozimet e paraqitura nga palët private dhe harton relacionin përmbyllës të negociatave, duke parashtruar çdo ofertë të paraqitur nga palët private dhe arsyetimin e përzgjedhjes së palës private me propozimin më të mirë.
5. Komisioni studion dhe vlerëson propozimin për zhvillimin e projektit, i cili duhet të përmbajë, minimalisht, dokumentacionin, si më poshtë vijon:
 - a) Analizën teknike, e cila duhet të përmbajë sfondin e projektit, konceptin e projektit, vendndodhjen, sipërfaqen e përgjithshme publike e private të zbatimit të projektit, studimet topografike dhe gjeologjike, përshkrimin konstruktiv, funksional e teknik të projektit, standardet teknike, periudhën e vlerësuar të ndërtimit të teatrit;
 - b) analizën ekonomike dhe financiare, e cila duhet të përmbajë kostot e projektit;
 - c) çdo dokumentacion tjetër, që do t'i shërbejë për kryerjen e negociatave;
 - d) sigurimin e ofertës me 2 % të vlerës së projektit të propozuar.
6. Bashkia e Tiranës është përgjegjëse për hartimin dhe administrimin e të gjitha procesverbaleve e dokumenteve të procedurës, si dhe të çdo dokumenti tjetër, që lidhet me procedurën e përcaktimit e të negocimit të kushteve të kontratës, përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Vokshi – Nuk na e jep fjalën.

Ilir Beqaj - “Neni 7

Procedura e vlerësimit, negocimit dhe lidhjes së kontratës

1. Procedura e vlerësimit dhe negocimit për lidhjen e kontratës kryhet nga komisioni i përcaktuar sipas këtij ligji.
2. Përzgjedhja e palës private që do të marrë përsipër projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar bëhet sipas procedurës konkurruese të përcaktuar në këtë ligj.

3. Kriteret kualifikuese dhe vlerësuese të procedurës konkurruese dhe dokumentacioni i kërkuar përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave, sipas pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji.

4. Bashkia e Tiranës, në datën e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për ngritjen e komisionit, publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen e saj zyrtare njoftimin për depozitimin nga çdo palë e interesuar të propozimeve për zhvillimin e zonës urbane të Teatrit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

5. Çdo palë private e interesuar mund të paraqesë projektin për zhvillimin e zonës së Teatrit dhe të depozitojë dokumentacionin përkatës pranë Bashkisë së Tiranës, brenda 60 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit.

6. Komisioni, bazuar në kriteret kualifikuese dhe vlerësuese dhe në dokumentet shoqëruese të depozituara, brenda 30 ditëve nga dita e përfundimit të afatit, sipas pikës 5 të këtij neni, miraton dhe shpall klasifikimin e palëve të interesuara.

Në rast se asnjë nga propozimet e paraqitura nga palët private nuk përmbushin kriteret, komisioni vendos përfundimin e këtij procesi, si një procedurë e pasuksesshme.

7. Në rast se asnjë nga palët e interesuara nuk paraqet ankim në lidhje me klasifikimin e shpallur nga komisioni, sipas pikës 6 të këtij neni, klasifikimi i miratuar nga komisioni konsiderohet përfundimtar

8. Çdo palë private ka të drejtë të paraqesë ankim, brenda 5 ditëve, tek kryetari i Bashkisë Tiranë, i cili e shqyrton atë brenda 5 ditëve nga marrja e ankesës. kryetari i Bashkisë Tiranë vendos :

- a. Konfirmimin e klasifikimit të bërë nga komisioni; ose
- b. dërgimin për rivlerësim komisionit.

9. Në rastin e kthimit për rivlerësim, komisioni e kryen atë brenda 10 ditëve dhe e përcjell klasifikimin e kryer te kryetari i Bashkisë. Nëse kryetari i Bashkisë, pas vlerësimit të dytë nuk është dakord me vlerësimin e komisionit procedura anulohet, si një procedurë e pasuksesshme.

10. Komisioni vazhdon negociatat me palën private që është renditur e para në klasifikimin e shpallur prej tij, deri në dërgimin e projektkontratës dhe relacionit përmbyllës të negociatave të kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij.

11. Afati për negocimin dhe hartimin e projektkontratës finale me palën private të përzgjedhur nuk duhet të jetë më shumë se 45 ditë nga data e shpalljes së klasifikimit përfundimtar.

12. Kur pala private e përzgjedhur nuk vazhdon negociatat me omisionin brenda një afati prej 5 ditësh, atëherë Komisioni fton për negociata palën private të klasifikuar i dyti.

13. Komisioni mund të asistohet për marrjen e ekspertizave të specializuara nga një konsulent, i përzgjedhur sipas një procedure të veçantë, të përsheptuar, nga ana e Bashkisë së Tiranës, që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Kulturës, në vendimin e ngritjes së Komisionit, sipas pikës 1, të nenit 5, të këtij ligji.

14. Në rastin e një procedure të suksesshme për negocimin dhe nënshkrimin e kontratës me palën private, komisioni vendos si kusht në kontratë edhe detyrimin e palës private të përzgjedhur për të paguar vlerën përkatëse të paguar nga Bashkia e Tiranës, në rastin e parashikuar në pikën 13 të këtij neni, dhe/ose të kryerjes së ekspertizave të ndryshme, nëpërmjet ekspertëve privatë të fushave përkatëse.

15. Për nevoja të punës të komisionit, korrespondencat me institucionet bashkëvepruese realizohen nga kryetari i komisionit, bazuar në vendimarrjet e komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për ngritjen e komisionit.”

Neni 8.

Kontrata dhe përmbajtja e saj.” Ky nen ndryshon kështu:

“1. Kontrata ndërmjet pronarit-shtet dhe palës private duhet të përmbajë propozimin e paraqitur nga shoqëria “Fusha” sh. p. k., sipas këtij ligji, i cili është vlerësuar nga komisioni negociator dhe do të jetë pjesë e pandashme e kontratës.

2. Kontrata, përveç kërkesave që burojnë nga Kodi Civil, parashikon ata terma që vlerësohen të përshtatshëm nga palët dhe duhet të përmbajë, domosdoshmërisht, edhe këto elemente:

a) përkufizime, interpretime, natyrën dhe objektin e punëve që duhet të kryhen, cilësinë e punimeve për ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar;

b) afatet dhe kohëzgjatjen e kontratës, në lidhje me fillimin dhe përfundimin e punimeve për godinën e re të Teatrit Kombëtar;

c) teatri do të jetë i plotë dhe funksional në ditën e dorëzimit, sipas afatit të përcaktuar, ku do të përfshihen, ndërtimi i objektit, mobilimi i brendshëm, instalimet teknologjike të skenave, instalimet audio/video, si edhe të çdo elementi tjetër të nevojshëm për një teatër bashkëkohor dhe modern;

ç) pronësinë e aseteve, përcaktimin e sipërfaqeve përkatëse shtet, që do të vendosen në dispozicion të palës private, duke marrë shteti përsipër garantimin e aksesit në zonë dhe/ose servitutet e kalimit, sipas projektit (që garantojnë hapësirat funksionale të projektit, rrugët e kalimit dhe aksesin publik), lehtësitë dhe kushtet e tjera për t'u plotësuar nga shteti, në shkëmbim të përfitimit të godinës së re të Teatrit Kombëtar dhe sipërfaqeve ndërtimore që mund të përfitojë Bashkia e Tiranës;

d) të drejtat dhe detyrimet e institucioneve shtetërore përgjegjëse për garantimin e së drejtës së pronësisë mbi pronat shtetërore, të vendosura në dispozicion për zhvillimin e projektit deri në përfundimin e tij, duke garantuar të drejta të plota të pronësisë dhe marrjen përsipër për përballjen ndaj çdo pretendimi nga të tretët dhe pa ndikuar në ecurinë e projektit, si dhe duke marrë përsipër lirimin e aseteve nga përdoruesit dhe të sheshit të ndërtimit nga objektet publike;

dh) të drejtat dhe detyrimet e palës private, shoqërisë “Fusha” sh. p. k., në zhvillimin e projektit;

e) paraqitjen e një pasqyre financiare, që pasqyron garancinë ekonomike të palës private dhe/ose çdo dokument tjetër provues nga pala financuese, nëse ka, për garantimin e zhvillimit të projektit;

ë) sigurimin e kontratës për ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar, të depozituar në një bankë të nivelit të dytë nga ana e palës private ose nga një kompani sigurimi, që operon në Shqipëri, përpara përmbylljes së negociatave dhe pasqyrimin e kësaj të dhëne në relacionin përmbyllës;

f) dispozitat përfundimtare, lidhur me sanksionet kundrejt palëve, në rast të mospërmbylljes së detyrimeve të marra përsipër në kontratë dhe të përcaktimeve të këtij ligji;

g) standardet artistike, që duhet të ketë teatri;

gj) të drejtat e institucioneve përgjegjëse, pjesë e komisionit, për të ndjekur, mbikëqyrur dhe monitoruar procesin e ndërtimit të godinës së re të Teatrit Kombëtar dhe cilësinë e shërbimeve, që duhen përmbushur nga pala private;

h) parimet tregtare, financiare dhe ligjore;

i) çdo kufizim ose kusht të zbatueshëm për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të palës private, sipas kontratës;

j) përkufizimin dhe pasojën e forcës madhore, ndryshimin në ligj dhe ndryshimet e tjera, duke përfshirë çdo të drejtë të palëve për të kërkuar kompensimin ose rishikimin e kontratës;

k) kushtet dhe procedurat për ndryshimin dhe/ose përfundimin e kontratës, të drejtat dhe detyrimet e palëve, me kalimin e afatit apo përfundimin e kontratës;

l) ligjin e zbatueshëm dhe mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që mund të lindin ndërmjet institucionit përgjegjës dhe palës private;

ll) kushtin që, mbi tokë, godina e re e Teatrit Kombëtar, është një godinë më vete, pa asnjë ndërtim tjetër, përveç pjesëve ndihmëse të saj, dhe se i gjithë investimi do të përballohet nga pala private, sipas parimit me “çelësa në dorë”;

m) procedurat për dorëzimin nga ana e palës private dhe të marrjes në dorëzim nga institucioni përgjegjës i godinës së re të Teatrit Kombëtar;

n) kushtin që pala private të fillojë, fillimisht apo paralelisht, godinën e Teatrit Kombëtar gjatë zhvillimit të projektit në zonën urbane;

nj) procedurat për dorëzimin nga ana e palës private dhe të marrjes në dorëzim nga Bashkia e Tiranës të sipërfaqeve takuese ndërtimore;

o) çdo dispozitë tjetër, bazuar në legjislacionin në fuqi për lidhjen e kontratave;

p) hyrjen në fuqi të kontratës, pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 9, nuk ndryshon.

Neni 10, nuk ndryshon.

Neni 11.

Në nenin 11, shprehja “45 ditë të zëvendësohet me shprehjen “30 ditë”.

Neni 12, nuk ndryshon.

Këto janë propozimet e bëra.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Për pjesën e ndryshimeve të paraqitura, doni të shpreheni, doni kohë, sepse, sinqerisht e nisa mbledhjen duke shpresuar se do të shmangeshin, të paktën, ato shashkat dhe tymnajat. Jam i predispozuar në këtë komision, e kam provuar vazhdimisht gjatë gjithë kohës që kam drejtuar këtë komision, që të mos u cenohet asnjë e drejtë dhe duke mbajtur mend sa kemi vuajtur në opozitë, të mos përsërisim ato gjëra që kanë ngjarë në këtë komision. Jam shumë i ndjeshëm te pjesa racionale, por krejtësisht i pandjeshëm, (madje, kolegu tha “i paturshpshëm”) kur vjen puna për shprehjet e mungesës minimale të etikës në komision.

Nuk vlen për të gjithë, u drejtohem disave, atyre që janë protagonistë, në aspektin procedural dhe të diskutimit në lidhje me sa u paraqit.

Ka ndonjë...

(Debate pa mikrofon)

Endrit Braimllari - S’ju vjen zor!

Eduard Shalsi – Kur ju thashë nuk ju drejtohem...

(Debate pa mikrofon)

Me sa shoh, nuk keni... Tolerova një epitet dhe të folur këtu që po dal jashtë vetes. Po ju kërkoj t’i tërhiqni vërejtje njëri-tjetrit dhe të mos lejojmë...

(Debate pa mikrofon)

Në rastin më minimal që do të...

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë, ju lutem, pasi fjalën e ka kërkuar zoti Alibeaj!

E vetmja gjë që mund t’ju them është se në rastin më të parë do të kalojmë në votim. Ju merreni si të doni, por në rast se disa tipa, sepse sa më kokëbosh të jesh, aq më arrogant je, do të fillojnë të kërcënojnë këtu...

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk u jam drejtuar të gjithëve, por në rastin më të parë do e kalojmë në votim dhe kështu mbyllet diskutimi, në qoftë se ju kërkon racionalitet.

Zoti Alibeaj, fjala për ju.

Enkelejd Alibeaj – Që ju ju ka kapur Fusha dhe ju ka futur në thes, kjo nuk do fare kallauz për t’u marrë vesh, por të kesh frikë nga fjala, kjo është e tmerrshme. Që juve ua kanë lidhur duart dhe nuk e di se me çfarë çmimi, nuk ka as të madh e as të vogël të mos e ketë marrë

vesh. Sa për respektimin e Rregullores e mira do të ishte të mos u drejtohesh deputetëve me termat që iu drejtuat: jo legen...

Eduard Shalsi – Si?

Enkelejd Alibeaj – Po, ashtu iu drejtuat kolegut...

Eduard Shalsi – Unë!

Enkelejd Alibeaj – Po, ti...

(Diskutime pa mikrofon)

Meqë u përgjërove për respektim të rregullit, për respektim të moralit, për respektim të racionalitetit dhe të ndjesive të publikut, kisha diçka për të thënë.

E para, për procedurë, për ta kuptuar ata që duan ta kuptojnë, nëse ndonjëri prej jush do ta kuptojë, sapo votuat pranimin e dekretit të Presidentit. Që nga momenti që votuat dekretin e Presidentit, zotëria ka bërë plot 20 faqe, 8 apo 9 pika, që e rrëzojnë ligjin tuaj antikushtetues si në kundërshtim me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, vjedhje e hapur e pasurisë publike, pastrim i parasë së krimit. Të gjitha jua ka thënë këtu. Ju e votuat dhe nga ky moment procedura e këtij parlamenti, e këtij palo parlamenti, me rregulloren që ka, thotë vetëm një gjë: ligji që votuat në korrik ka rënë, nuk ka më ligj. Filtri i parë dhe i vetëm fatkeqësisht sot në këtë derexhe që jemi është dekreti i Presidentit, vetoja e Presidentit. Ja ku e keni, e ka rrëzuar ligjin!

Unë e kuptoj se çfarë doni të bëni ju. Ju doni të bëni vetëm një gjë, për të anashkaluar një tjetër rregull të Kushtetutës, ta pranoni dekretin e Presidentit, por ky zotëria këtu është duke futur disa amendamente të një ligji, i cili ka rënë tashmë. Amendamentet e cilit ligj, të atij që ka rënë? E vetmja gjë...

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk më mësoni dot ju për këto gjëra, më dëgjoni, sepse jam duke folur edhe për ty.

(Diskutime pa mikrofon)

Ta tregoj edhe dorën.

Pra, e vetmja gjë për ta çuar deri në fund planin tuaj të hajdutërisë është të filloni një procedurë të re ligjore, një iniciativë ligjore, por këtu kemi një ndryshim të madh. Nëse filloni një iniciativë të re ligjore për ta vjedhur dhe për t'i vënë minat teatrit, ju nuk ia hiqni dot të drejtën Presidentit të Republikës që ta rrëzojë përsëri atë ligj. Ky është mashtrimi që kërkon të bësh ti me kolegët e tu!

Është vullneti juaj, doni të vidhni dhe këtë e keni treguar. Ju ka futur Fusha dhe Rama në xhep dhe nuk keni fare më cipë për këtë pikë, por mos bëni as naivin, as shurdhin dhe as jointeligjentin me procedurën parlamentare. Sot ju mund të përfitoni nga fakti që nuk ka Gjykatë Kushtetuese, ia vutë asaj minat të parës, ia vutë minat Gjykatës Kushtetuese, do t'i vini minat Teatrit Kombëtar (nëse do t'ju lejojmë).

Ju sot po bëni edhe këtë gjënë tjetër, po rrëmbeni të vetmen kompetencë që mund t'i vërë fre arrogancës dhe hajdutërisë suaj, që është e drejta e Presidentit për ta rikthyer ligjin mbrapsht.

Kjo është përgjigjja që po i jepni ju Komisionit European?! Kjo është përgjigjja që po i jepni ju Bashkimit European?

Komisioni European ju tha: “Zbatoni Kushtetutën, zbatoni ligjet e brendshme, zbatoni rregullat dhe standardet kushtetuese”. Dhe çfarë bëni ju?! Ju përsëri ia jepni Fushës. Jo vetëm kaq, por po vidhni edhe kompetencën e Presidentit. Po bëni disa amendamente në ajër, të një ligji që nuk ekziston dhe do ta votoni nesër, pasnesër. Kjo është çështja.

Unë e kuptoj që jeni futur në një histori pa krye. Në fakt, edhe kjo e sotmja, përveç qaravitjeve të kryetarit të këtij komisioni, nuk është gjë tjetër.

Tani, po demonstoni edhe një herë, faktin, provën, shembullin, dokumentin, se si krimi ju ka kapur të gjithëve, pa përjashtim.

Eduard Shalsi – Qartë, qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Të gjithëve. Edhe ti, edhe ti, edhe ti, edhe zonja atje... Ai zotëria aty, e provoi një herë, e përjashtuan dhe u kthye prapë.

Ju jeni të gjithë të lidhur me krimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Beqaj, mos u merr fare...!

Enkelejd Alibeaj - Kjo është prova e lidhjes suaj me krimin. Shqiptarët duhet ta shohin këtë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Beqaj, të lutem!

Enkelejd Alibeaj – Ju, sot, së paku nuk keni guximin dhe nuk keni minimumin e respektit për veten...

Eduard Shalsi – Kush është dakord me propozimin për ndryshimin e nenit...

Enkelejd Alibeaj – Ja përse duhet vetingu në politikë sot! Ja, për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Turp i madh!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më shqetëson pikërisht vjedhja. Fakti që ti, zotëri, nuk je gjë tjetër veçse një njeri i dërguar nga bandat dhe nga Fusha.

Eduard Shalsi – O Rakip...

(Debate pa mikrofon)

E futi në vorbull.

Rakip Suli – Ju, si parti, më së fundi keni bërë një propozim për vetingun e parlamentarëve.

Enkelejd Alibeaj – Ja ku është prova.

Rakip Suli - Ti dhe unë, të dalim të parët dhe ta bëjmë vetingun bashkë.

Enkelejd Alibeaj – Ja shembulli i parë!

Mos e votoni këtë ligj!

Rakip Suli – Të sfidoj: unë dhe ti të bëjmë të parët veting në parlamentin shqiptar.

Enkelejd Alibeaj – Mos e voto këtë ligj ti!

Rakip Suli – Nuk ka nevojë Shqipëria për fjalë, miku im!

(Debate pa mikrofon)

Eduard Shalsi – O Rakip...

(Debate pa mikrofon)

...kanë një aftësi të jashtëzakonshme të të çojnë në vulgaritet dhe në banalitet dhe ti kthen përgjigje!

Kush është dakord me propozimet për ndryshimin e nenit 1? Kundër? Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 3.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Debate pa mikrofon)

Neni 7.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Debate pa mikrofon)

Neni 8.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Debate pa mikrofon)

Neni 11.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Debate pa mikrofon)

Këtu përfundon mbledhja.

(Debate pa mikrofon)

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA